

Data 25.01.2023.

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“ Blerje karburant “

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

karburante-09100000-0.

VLERA E FONDIT LIMIT:

13 685 010(trembedhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dhjetë) Leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Librazhd ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c) Formularin e ofertës ekonomike .

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Xhiroja mesatare vjetore për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, duhet të ketë një vlerë të paktën 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, pa përfshirë vlerën e TVSH-së, për të cilin duhet të paraqitet vërtetim i leshuar nga administrata tatimore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëq Operatorët Ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe nenin 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" etj.

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve 2020 – 2021 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit. Shenim: Në respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenin 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci të kërkuar nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur në zbatim të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika “c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

2.3 Pervoja e ngjashme :

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontrata të mëparshme , të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Vlera e kërkuar për realizimet e mëparshme duhet të jete te minimalisht deri ne 40% e vlerës te kontrates qe po prokurohet dhe që janë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete OE duhet te paraqese si dëshmi për përvojën e mëparshme,

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara . (Per kontratat ne sektorin publik).
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën minimalisht 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Aftesite teknike dhe profesionale

2.3.2. Subjekti ofertues duhet të paraqesë stacionin e shitjes së karburantit me pakicë në qytetin ku ka vendndodhjen autoriteti kontraktor, pra në Qytetin e Librazhdit, vertetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronësie ose të jetë e pasqyruar në ekstraktin e QKB, etj).

2.3.3 Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant në çdo ditë me shërbim 24 orë, sipas nevojave që ka Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikate marke për mallin që ofron, në përputhje me nenin 154, të Ligjit Nr.9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar.

2.3.5.Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikate ISO 9001-2015 (Për menaxhimin e cilësive, e vlefshme) ose e perditesuar.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore kodit III.1 B në zbatim të Ligjit me nr. 10 448, datë 14.7.2011 " PËR LEJET E MJEDISIT", si edhe akteve të tjera nenligjore në zbatim të tij.

2.3.7.Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.561, datë 29.07.2016 "Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së shpenzimeve", operatori fitues në këtë procedurë prokurimi duhet të ofrojë shërbimin e furnizimit me karburant të mjeteve nëpërmjet kartave elektronike. Për këtë subjekt duhet të paraqesin Manuali i Përdorimit të Sistemit Elektronik i Furnizimit me karburant me Kartë Elektronike.

2.3.9.Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, sipas adresave të kerkuara nga Autoriteti Kontraktor. *(Deklarate nga subjekti ofertues).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nënnt 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, si dhe Ligjit Nr.9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.561, datë 29.07.2016 "Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së shpenzimeve", Ligjit me nr. 10 448, datë 14.7.2011 " PËR LEJET E MJEDISIT", si edhe akteve të tjera nenligjore në zbatim të tij etj.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Ne respektim te nenit 36, 37 te LPP-se ne te gjitha rastet kur permendet “marke” perfshihet termi “ ekuivalent ”.

Sqarim per ofertuesit : Ne respektim dhe zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, neni 26 neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021. Në çdo rast, përpara se te publikoje njoftimin e fituesit dhe perpara se te fillojne afatet e ankimit, autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Te dhenat e meposheme jane pergatitur nga komisioni i perllogaritjes se vleres se fondit limit dhe hartimit te specifikimeve teknike.